



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 22.02.2013
Nr. 0204-148

PËR: Avni Kastrati, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Rrustem Musa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS
SË MITROVICËS, Nr.02/05 -1460/8, Pranuar me datë, 11.02.2013**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-04, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 02/06 -1460/8 të miratuar me datë 31.01.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 02/06 -1460/8 Miratohet në Parim Rregullorja për Disiplinë të Nxënësve në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët, në pajtim me nenin 27 të Statutit të Komunës vihet në Diskutim Publik.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 22.02.2013
br. 0204-148

Za: Avni Kastrati, Gradonačelnik opštine Mitrovica
Rrustem Musa, Predsedavajući Skupštine opštine Mitrovica

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Mitrovica, br.02/06 -1460/8, Prilmljeno dana , 11.02.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 02/06 -1460/8 odobreno dana 31.01.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi .

- Odluka br. 02/06 -1460/8 odobrava se u principu uredba o disciplini učenika u osnovnoj i srednjo-višoj školi u skladu sa članom 27 Statuta opštine daje se na javnoj diskusiji.


Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

KUVENDI I KOMUNËS

Nr. 02/06 – 1460/8 dt. 31.01.2013

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c të Ligjit Nr. 03/L – 040 për vetëqeverisje lokale; nenit 23 paragrafi 2 pika c të Statutit të Komunës së Mitrovicës, si dhe në mbështetje të nenit 49 paragrafi 4 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar Ligji Nr. 04/L-032, Udhëzimeve Administrative të MASHT-it për rendin dhe disiplinën e nxënësve të shkollave fillore të mesme të ulëta, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 31.01.2013 pasi shqyrtoi Draft-rregulloren për disiplinë të nxënësve në shkollën fillore të mesme të ulët, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02/06 – 416/7 dt. 17.01.2013); sjell këtë:

VENDIM

1. MIRATOHET NË PARIM Rregullorja për disiplinë të nxënësve në shkollën fillore të mesme të ulët, dhe në pajtim me nenin 27 të Statutit të Komunës vihet në diskutim publik.
2. Diskutimi publik rreth Rregullore për disiplinë të nxënësve në shkollën fillore të mesme të ulët do të zgjas 14 ditë nga dita e shpalljes së këtij vendimi në tabelën e shpalljeve publike të Komunës dhe ueb faqen e Komunës.
3. Obligohet Kryetari i Komunës të organizojë debat dhe konsultime me qytetarë dhe grupe të interesit rreth rregullore.
4. Obligohet Komisioni Statutar që konform nenit 27 pika d të shqyrtojë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura në diskutimin publik, të përgatisë një raport me vërejtjet e pranuar dhe t'i dorëzohet për miratim Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës.
5. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja (e miratuar në parim) për disiplinë të nxënësve në shkollën fillore të mesme të ulët.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Dr. Rrustem MUSA

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryetarit të Komunës
- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 Kryetarit të Komisionit Statutar
- 1 x 1 Arkivit